

KUD 368.1(96.51)

INDUSTRIA E SHËRBIMEVE FINANCIARE – INSTITUCIONET E SIGURIMIT SI PJESE E SAJ

Dr. Fatos Ukaj
fatos_ukaj@yahoo.com

Abstrakt

Ndodhë që shpesh të kemi mëdyshje rreth asaj se si të emërtohet pjesa e ekonomisë që merret me kryerjen e veprimtarisë në kuadër të operacioneve me financa por aty na paraqitet ndarja e këtyre operacioneve në ato: Bankare dhe Jobankare. Në pjesën e Industrisë së Shërbimeve Financiare që emërtohet si Jobankare hynë edhe Institucionet e sigurimit. Sigurimi si emërtim e ka rendësinë e vetë si sinonim i mbrojtjes dhe besimit në garancën e dikujt, po ashtu e ka rendësinë ekonomike dhe juridike. Në Kosovë çështja e Sigurimeve është e trajtuar në një periudhë kohore me se 100 vjeçare duke kaluar neper periudha të ndryshme të implementimit të sigurimit qoftë të pasurisë po ashtu edhe të jetës. Periudha e cila mund të trajtohet si kohe e instalimit të një sistemi ku institucionet e sigurimit patën shtrirje dhe forcim të veprimtarisë së vetë, është periudha që nga viti 2000 e këndej. Nevoja për individin dhe subjektet juridike të kenë mbrojtje nëpërmes sigurimit e mundësuan që institucionet e sigurimit të shtohen në numër dhe në fuqinë e vetë financiare për të ofruar mundësi për mbulimin e të papriturave. Sigurimi si veprimtari edhe në Kosovë përveç rendësisë së vetë në aspektin nacional, po e fiton rendësinë edhe në nivel internacional.

Fjalët kuqe: Industria e Shërbimeve financiare, Sigurimet, Siguria, I siguruari.

Jel klasifikimi: G2 - Financial Institutions and Services, G22 - Insurance; Insurance Companies

Abstract

It happens often that we doubt the issue of how to name a part of economy that deals with activities in specific field of finance, but there we have the separation of these operations in two groups, which are: Banking and Nonbanking. In the field of Financial Industry and Financial Services that are named as Nonbanking, Institutions of Insurance take place also. Insurance as a term, has its own importance like a synonym of protection

and confidence on guaranty given by someone you trust, also it has its own economic and legal importance. In Kosovo, Insurance issue is treated in a time period of more than 100 years, passing through different periods of implementations, those of property insurance and life also. The period which can be treated as a time of installation of a system where the insurance institutions had a range and strengthen of their own activity, is the period from the year 2000 and onwards. The need of individual and legal subjects to have protection via insurance enabled the insurance intuitions to increase in number and their own financial power in order to be able to offer the chance of covering the contingencies. Insurance as an activity, in Kosovo also except of its importance in national terms, it is gaining importance in international level.

Key words: Industry of Financial Services, Insurances, Security, Insured,

JEL classification: G2 - Financial Institutions and Services, G22 - Insurance; Insurance Companies

1. HYRJJE

Ne historinë e re të Kosovës është evidente se ka një qasje serioze në ndërtimin e një Industrie të Shërbimeve Financiare. Duke u nis nga nevoja e shkëmbimit në nivel vendi dhe ati ndërkombëtar ju kushtua rendësi formimit të një sistemi bankar efikas dhe optimal për nevojat e popullsisë dhe ekonomisë se vendit. Vëmendja me kohe u orientua edhe në kuadër të nevojës se paraqitur për shërbimet e sigurimit të pasurisë dhe jetës. Implementimi i ligjeve mbi sigurimet e detyrueshme e mundësuan funksionalizimin e shoqërive të sigurimit të formuara si etnitete juridike Kosovare , me kapital vendor dhe ndërkombëtar. Përvoja e periudhës para vitit 1999, dhe disponimi me resurse materiale dhe njerëzore të specializuara për punët në Sigurime, e mundësuan ngritjen e shpejt të një numri shoqërish për sigurime, që e mbuluan nevojën e paraqitur për sigurime në nivel vendi. Deri në vitin 199 në Kosove ka operua Bashkësia e sigurimeve të personave dhe pasurisë “Kosova”, si dhe Filialet e Bashkësive të Sigurimit nga pjesët tjera të ish Jugosllavisë. Janë 14 shoqëri të sigurimit të licencuar nga na e Banka Qendrore e Kosovës (BQK) për operime në Kosove në lëmit e ndryshëm të sigurimeve[BQK01/2011]. Dështimi i pjesshëm në arritjen e ndërkombëtarizimit të Industrisë Kosovare të Sigurimeve e lanë popullsinë dhe ndërmarrjet Kosovare jashtë mundësisë që me policat e Shoqërive Kosovare të Sigurimeve të mund të ishin të mbuluar edhe jashtë shtetit, pra pranimi i policave të Shoqërive të Sigurimit nga Kosova në vendet Evropës e me gjere. Duhet përmendur si përparësi për të siguruarit në sistemin TPL

marrëveshja e arritur me Maqedoni dhe Shqipërinë për mbulimin e sigurimit me polica Kosovare në këto vende.

2. ROLI DHE RËNDËSIA E SIGURIMEVE

Njeriu vazhdimisht është përball me mundësin e pësimit të humbjes apo pësimit të ndonjë të papriture që ka si rrjedhojë dëmtimin, apo humbjen e jetës, shëndetit apo pasurisë. Për këtë arsye edhe janë organizua mënyra të ndryshme të sigurimit, që janë përsosur pasi që edhe gjithnjë në këtë shoqëri dinamike paraqiten rreziqe të reja. Përveç se njerëzit dhe ndërmarrjet marrin hapa në sigurimin e vete ata gjithashtu e shohin si të nevojshme që të organizojnë mbrojtje nga aktiviteti vete që munde të rezultojë me humbje për jetën dhe pasurin e personave tjerë. Por duhet cekur se në shumicën e rasteve nuk ekziston mundësia dhe fuqia financiare që vete të organizohet mbrojtja nga rreziqet.

Sigurimet kane një histori të veten të zhvillimit si aktivitet në kuadrin e shërbimeve financiare, apo si biznes është i lidhur me individët dhe grupet e individëve por edhe me ndërmarrje dhe grupe ndërmarrjesh qofte ato prodhuese apo shërbyese. Që në Historinë e lashte të Kinës dhe Babilonisë, duke vazhdua në Greqinë antike e Romen antike, me pastaj në Mesjete ku kemi themelet e një aktiviteti të veçantë në lëmin e sigurimeve të mallrave dhe pasurisë. Në vijim dallojmë themelimin e institucioneve për sigurime si Angli, “Loyds” që nga viti 1688 si grupim i nënshkruesve(undewriter) e gjer në vitin 1771 kur Loyds u institucionalizua si shoqëri e sigurimeve, në Gjermani Shoqata e zjarrfikësve “Feuer Casse” në vitin 1591, Në SHBA themelohet grupi ”Philadelphia Contributionship for the Insurance of Houses from loss by Fire” në vitin 1752 [I.Hoti 2008; K.Klasić& I.Andrijaniq 2009], e kështu me radhe deri në kohërat moderne kur shtrirja dhe format e shoqërive të sigurimit morën formë dhe mbulojnë rreziqe nga me të ndryshmit , duke u përshtat zhvillimeve shoqërore, ekonomike dhe teknologjike.

Edhe në Kosove ndeshemi me zhvillimin e biznesit të sigurimeve sidomos pas vitit 1999, dhe dallojmë shoqëritë e sigurimit të cilat mund të jene të specializuara për lloje të veçanta të aktiviteteve në sigurime, apo ato universale që në fakt merren me aktivitete në me shume lloje të sigurimeve. Nevoja e vendit për të pas zhvillim ekonomik, si dhe lidhjet me ekonominë ndërkombëtare e nxiten edhe zhvillimin e biznesit të sigurimeve, që në fakt ka dy funksione që i ndihmon shtetit dhe ekonomisë, njëra është funksioni i saj në zvogëlimin e pasigurisë për individ dhe ndërmarrje dhe në anën tjetër funksioni i grumbullimit të kapitalit. Në industrinë e sigurimeve të Kosovës janë tri lloje të aktiviteteve në sigurime, apo sigurimet ndahen në tri lloje, dhe atë në: sigurime të përgjithshme, sigurime të jetës, dhe risigurime.

Rëndësia e një mundësie për tu sigurua është inkurajuese sidomos për bizneset dhe Investitorët e jashtëm që dëshirojnë të zhvillojnë biznes në Kosovë. Shoqëritë e sigurimit janë të obliguara që të menaxhoj me nikoqirllëk me burimet e veta dhe me investimet ashtu që në çdo rast të jete në gjendje ti plotësoj obligimet e arritura ndaj të siguruarve. E këtë do të duhej ta arrijnë duke e zbatua politiken e menaxhimit të rregullt të likuiditetit. Mbikëqyrja e shoqërive të sigurimit në Kosovë behet nga Banka qendrore e Kosovës(BQK).

3. ORGANIZIMI DHE VEPRIMTARIA E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT

Në Kosovë një shoqëri e sigurimit mundet dhe duhet të organizohet në forme të shoqërisë aksionare. Aksionet janë pjese e kryegjësë themelore, dhe janë të bartshim, ashtu që të mundë të shiten dhe të blihen. Shoqëritë e sigurimit në Kosovë mundë të themelojnë personat vendor fizik dhe juridik, por edhe ata të huaj. Në këtë vazhde është e përcaktuar edhe shuma e kapitalit themelues për lloje të caktuara të sigurimit, që është e rregulluar me ligj dhe e njëjta mund të ndryshohet vetëm me vendimet e BQK, si mbikëqyrëse e institucioneve financiare , pra edhe të shoqërive të sigurimit. Përpos kushteve të përcaktuara nga BQK, shoqëritë duhet të përmbushin edhe kushtet e përcaktuara me ligjin mbi shoqëritë tregtare. Pra të regjistrohen si biznese vendore, pa marre parasysh prejardhjen e kapitalit, a është vendor apo nga jashtë vendit. Në baze të ligjit mbi shoqëritë tregtare edhe organizohet dhe udhëhiqet si subjekt ekonomik. Është e përcaktuar se një shoqëri e sigurimit nga fusha e sigurimit të përgjithshëm nuk duhet të ofroj shërbime nga sigurimi i jetës, dhe anasjelltas. Në baze të autorizimeve, BQK e rregullon me rregullore dhe udhëzime licencimin dhe i mbikëqyr shoqëritë e sigurimit dhe ndërmjetësuesit e sigurimit. Në fushën e sigurimit lejohen dhe veprojnë filialet e shoqërive të sigurimit, agjencitë, agjentet, nënagjentet dhe komisionarët e sigurimeve. Është e përcaktuar nga BQK edhe shuma e mjeteve që duhet të mbajnë brenda Kosovës, për të mbuluar kërkesat për zhdëmtim, e që duhet të jene të mjaftueshme. Këtë duke e dite se një prej funksioneve të sigurimit është grumbullimi i mjeteve financiare të cilat investohen dhe sjellin interes. Mjetet nga sigurimi kane funksion financiar-akumulues dhe shoqëror-social, ne shoqëri [Xh.Bakraqi 2007]. Duhet nënvizuar se BQK i cakton limitet që kane të bëjnë me shumën e premive që shoqëria e sigurimit mund të shkruaj. Premia si çmim i sigurimit, duhet të jetë proporcionale ndaj rrezikut te siguruar ne kohën e caktuar, pra që të jetë adekuat ndaj periudhës kohore në të cilën mbulohet rreziku.[P.Šuljević 2005] Ndërsa për shumën e humbjeve të parapara maksimale,shoqëritë e sigurimit duhen marre masa për risigurimin e atyre

rasteve, dhe atë vetëm me kompanitë e pranueshme për BQK-ne. Për një numër të rasteve kur shoqëritë e sigurimit dëshirojnë të hyjnë në transaksione financiare siç janë produktet derivate në sigurime (opsionet, këmbimet, variacionet, etj) duhet të marrin miratimin paraprak nga BQK. Shoqëritë e sigurimeve që janë bashkësi e të siguruarve e kanë synim realizimin e fitimit, por në raste kur realizohet fitimi, asnjë pjese e tij nuk mund të shpërndahet qoftë për aksionaret, qoftë për stimulimin e të siguruarve, pa miratimin e BQK. Kontrolli i shoqërive të sigurimit nga ana e BQK bëhet edhe nëpërmes mbikëqyrjes se vazhdueshme ,që mund të rezultojnë me ndëshkime dhe anulime të licencës, që mund të bëhet edhe pa njoftime paraprake të vete shoqërisë se sigurimeve apo të ndërmjetësuesve të sigurimit konkret. Pra masat që nga vërejtjet me shkrim, ndëshkimet dhe deri tek tërheqja e licencës, janë të plotësuar edhe me masat ndaj menaxhmentit dhe vete aksionarëve. Ekziston mundësia dhe kjo është implementu në praktik, ku sipas rregullores shoqërisë se caktuar të sigurimeve ju ka marre licenca, është fut në procesin e likuidimit dhe është shitur, me këtë është ndërrua pronësia. E gjithë kjo bëhet me arsyetim të mbajtjes se disiplinës në funksionimin e tregut të sigurimeve, mos të mbizotëroj konkurrenca jolojale , por edhe të mbrohen të siguruarit nga hazardi moral i shoqërive të sigurimit. Shoqëritë e sigurimit e kanë formuar për interesa të përbashkëta Shoqatën e sigurimeve të Kosovës(IAK), e cila është në bashkëpunim të ngushtë me BQK si institucion që e mbikëqyr dhe e kontrollon edhe industrinë e sigurimeve.

Tabela 1. të dhënat për aktivitetet e shoqërive të sigurimit për muajin Nëntor 2010

Nr	Emërtimi	PPT	Policat Kufitare	Tjera (jo PPT)	Gjithsejtë
1	Shuma e premive të pranuara	37.6	9.8	18.7	66.1
2	Numri i Policave të Shitura(ne 000)	238	175	83	496
3	Shuma e dëmeve të paguara	17.3	1.0	5.3	23.7

Burimi: BQK 01/2011

Mbetet edhe me tej produkti kryesor që e kontraktajnë e shoqëritë e sigurimit në Kosovë , Sigurimi i përgjegjësisë ndaj palës së Tretë (PPT), me se 61% e tërë premive të arkëtuara janë nga shitja e policave PPT. Në të njëjtën periudhë, muaji qershor 2010 shuma e dëmeve të paguara arriti vlerën e me se 13 milion eurosh, dhe në këtë shumë demet e paguar për mbajtësit e policës së PPT ishte me se 74% e të gjitha dëmeve të paguara[BQK 2010].

4. OPERACIONET E SHOQËRIVE TË SIGURIMIT NË TREGJET E KAPITALEVE

Ne aktivitetet e tyre shoqëritë e sigurimit arkëtojnë premitë në momentin e lidhjes së kontratës, dhe si rrjedhojë është fakt se behet grumbullim i vlerave monetare të cilat ka mundësi që të investohen. Në anën tjetër shoqëritë e sigurimit e kanë edhe një alternativ tjetër për të instrumentalizua rrezikun, duke e bërë sigurimin e rrezikut me shëndrrimin e rrezikut në të sigurt financiare (financial security).

Kur behet fjale për procesin e instrumentalizimit të rrezikut e gjitha fillon me lëshimin e obligacioneve të katastrofës, dhe opsioneve të klimës, si instrumente financiare [I. Hoti 2008].

Me këtë rast kemi të bëjmë me lidhjen e një kontrate ku palët pajtohen se do të behet: investimi, niveli i normës së interesit, afatin e kontratës, e cila parasheh kthimin e investimeve në të ardhmen. Me këtë rast shoqëria e sigurimit emeton “obligacionet e katastrofës” dhe huamarrin duke ju zotuar blerësve të obligacioneve se pas maturimit do të fitojnë për kapitalin e huazuar një interes me përqindje fikse. Mirëpo çështja është se këtë interes ata do ta fitojnë vetëm nëse nuk ndodhë katastrofë, me këtë rast pra ata do të marrin shumë themelore dhe interesin. E çka nëse ndodhë katastrofa, shtrohet pyetja. Pra huadhënësi në këtë rast do të zbritet humbja e rezultuar nga katastrofa (për shoqërinë e sigurimit) nga shuma e investuar në obligacione të katastrofës, si dhe nga interesi i grumbulluar nga investimi në obligacione. Duhet potencuar këtu se shoqëritë e sigurimit në këtë rast ofrojnë interes të lartë, por edhe ky investim paraqitet me rrezik të lartë, në tregjet e kapitalit, dhe ju tërhiqet vërejtja për këtë investitorëve potencial.

Tek instrumenti tjetër financiar i përdorur nga shoqëritë e sigurimit e që është “Opsioni i Klimës” që në realitet është instrument që lidhet për demet e pësura nga goditjet klimatike. Këto dame mund të jenë si pasojë e thatësisë, reshjeve, ngricave, breshëri, etj. Ai i cili investon në këtë instrument e përfiton kompensimin nëse ndodhin demet e shkaktuar nga ndryshimet ekstreme në klimën e vendit, të cilat rezultojnë me humbje, zakonisht katastrofike.

Edhe pse e cekem se këto instrumente në fakt kanë rrezik të lartë, për to ka interesim të atyre që dëshirojnë të bëjnë diversifikimin e kapitalit të vetë, por edhe shoqëritë e sigurimit në këtë mënyrë e rrisin aftësinë e vetë, apo kapacitetin sigurues [I. Hoti 2008].

Mënyrë tjetër e angazhimit të mjeteve të mbledhura nga të siguruarit, që përdoret nga shoqëritë e sigurimit është investimi i këtyre mjeteve në instrumente të ndryshme në tregjet financiare, normalisht se edhe këtu i kushtohet kujdes, shpërndarjes apo diversifikimit të këtyre investimeve në formë të ndryshme që nga investimet në letra me vlerë, blerjen e aksioneve të korporatave të ndryshme, pjesëmarrja në ndërtimtari, investimi në banka, depozitimi i mjeteve tek institucionet bankare, etj. Këto mjete të fituara nga këto investime, për shoqëritë e sigurimit paraqet burim

për mbulimin e humbjeve të siguruara të përjetuara, pjese e këtij fitimi mund të ndahet edhe për dhënien e lirimeve në forme bonusi për të siguruarit e vete, etj. Këtu duhet bere të qarte se premitë e pranuar në vlera monetare ka mundësi që e humbin vlerën e vete, apo fuqinë blerëse nga shume faktorë , e një nder ta numërohet inflacioni. Shoqëria e sigurimit pra i kushton kujdes nevojës se ruajtjes se vlerës se mjeteve të grumbulluara por edhe ka detyre që ta rrisë atë vlerë me menaxhim maksimal të rrezikut gjate investimeve.

6. PËRFUNDIM

Praktikat e sigurimit në bote por edhe në Kosove hasen gjithnjë e me shpesh tek individët dhe ndërmarrjet apo institucionet. Format e organizimit janë nga me të ndryshmet dhe kane një trend të shtrirjes në të gjitha aktivitetet private dhe profesionale të individëve dhe ndërmarrjeve, pra me shtimin e produkteve të sigurimit. Organizimi i industrisë se sigurimit në Kosove ka pas në periudhën e deritanishme një ekspansion dhe i gjithë organizimi behet në baza të funksionimit të tregut dhe konkurrencës lojale të shoqërive të sigurimit të licencuara. BQK si institucion mbikëqyrës i shoqërive të sigurimit e bene kontrollin dhe rregullimin e kësaj veprimtarie me anën rregulloreve dhe udhëzimeve të veta, e krejt me qellim të mbrojtjes se mbajtësve të policave të sigurimit. Shoqëritë e sigurimit e kane formuar për interesa të përbashkëta Shoqatën e sigurimeve të Kosovës(IAK), me qellim të mbrojtjes se pjesëmarrësve në tregun e sigurimeve, avancimin e veprimtarisë se shoqërive të sigurimit, bashkëpunimin në mese të shoqërive të sigurimit vendore me ato ndërkombëtare, etj. Duhet dalluar se edhe përkundër avancimeve të bëra mbesin dallimet apo ngecjet në lëmin e sigurimeve në Kosove që janë specifike si rezultat i trashëgimisë historike, nga tranzicioni i zgjatur i ekonomisë vendore, çështja pronësore është një prej frenuesve të zhvillimit të mëtejme, ngritja e kuadrit profesional është gjithashtu një sfidë në vete. Kycja e shoqërive të sigurimit në hapësirën ndërkombëtare me produktet e veta është një sfidë e cila po zgjate shume gjate, dhe kjo e bene që edhe siguresit të mos kenë besim në aftësitë e shoqërive vendore, kur behet fjale për punët me karakter ndërkombëtar. Anëtarësimi në shoqatat e siguresve dhe risiguresve të Evropës dhe me gjere duhet të jete një prioritet për BQK, IAK, dhe Shoqëritë e sigurimit, sidomos pas njohjes se pavarësisë nga shume vende në bote.

Ndryshimet që ndodhin në lëmin e sigurimeve duhet të përcillen edhe me adaptimin e ndryshimeve në ligj mbi sigurimin, rregulloret dhe udhëzimet e BQK, me shfrytëzimin e konsulences profesionale, ose mundësisht me asistencën e organizatave ndërkombëtare.

7. LITERATURA

- [1] Ilir Hoti, “Industria e sigurimeve dhe Menaxhimi i Rrezikut”, Instituti i Inxhinierisë Financiare për Banke&Sigurime, Tirane, 2008.
- [2] Ksenija Klasiq dhe Ivo Andrijaniq, Bazat e Sigurimit, Universiteti Victory dhe Instituti i H.Sh . Victory, Prishtine ,2009.
- [3] Xhevat Bakraçi”Menaxhmenti i rrezikut dhe Sigurimet, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Ekonomik, Prishtine, 2007.
- [2] Predrag Šulejić, Pravo Osiguranja, Centar za Publikacije Pravnog Fakulteta u Beogradu, Beograd ,2005.
- [4]. Fatos Ukaj ” Support of Small - Medium Size Enterprises (SME) - Opportunity for Kosovo to Overcome Economic Crisis”, First on-line International conference “World’s Economies In and After Crisis: Challenges, Threats and Opportunities”-WECTO, ASERS Publishing, <http://www.asers.eu/asers-publishing>
- [5] Banka Qendrore e Kosovës. <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2011/BMS%20112.pdf>
- [6] Banka Qendrore e Kosovës , Raporti i stabilitetit Financiar 1, <http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2010/Raporti%20i%20Stabilitetit%20Financiar%20Nr.%201.pdf>
- [7] Enti i Statistikës së Kosovës <http://www.ks-gov.net/esk/>
- [8] Departamenti i Thesarit, MEF: <http://www.mef-rks.org/sq/download/2162-buletini-makroekonomik>